



**REPUBLIKA E SHQIPERË
UNIVERSITETI " FAN S . NOLI "
KORÇË**

**Adresa: Shëtitore "Rilindja" Tel/Fax: ++355 82 242230; ++355 82 242580
Web: www.unkorce.edu.al e-mail: rektorati@unkorce.edu.al**

MIRATOHET:

REKTORI

Prof. as. dr. GJERGJI MERO

FAKULTETI I BUJQËSISË

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË

AGROUSHQIM

VITI AKADEMIK 2014-2015

**DEKANI
Prof.as.dr. IRENA KALLÇO**

**PËRGJEGJËS I DEPARTAMENTIT
Dr. SPIRO GJANÇI**

**1. EMËRTIMI I PLOTË I PROGRAMIT TË STUDIMIT:
PROGRAM I STUDIMIT TE CIKLIT TE PARE :
AGROUSHQIM**

2. VENDIMET E ORGANEVE PËRGJEGJËSE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT:

Programi i studimit AGROUSHQIM, është hapur në vitin 1994 si **opcion duke filluar nga viti i tretë** i inxhinierisë agronomike, në bazë të një projekti të përbashkët me ENITA, Clermond Ferrand, Francë (nr projektit A BS/0461) me titull: “Mision pedagogjik për venien në zbatim të një arsimit inxhinieresh agro-ushqimore në Universitetin e Korçës”. Në kuadër të këtij projekti u specializuan në Francë tre pedagogë të fakultetit të tyre, duke sjellë dhe një seri lëndesh të reja së bashku me programet e tyre.

Ky program studimi funksionoi si i tillë deri në vitin 2006-2007 në sistemin 4,5 vjet sipas strukturës që gjendet në departament.

Në këtë vit u kalua në sistemin Bachelor dhe me profil Agroushqim.

Vendim Nr.230 date 29.5.1992 për hapjen e disa degëve në universitetin politeknik të Korçës.

3. OBJEKTIVAT FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MUNDËSITË QË AI I OFRON STUDENTIT PËR PUNËSIM

a) Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit.

Objektivi kryesor i programit Bachelor Agro-ushqim synon të japë studenteve njohuritë e nevojshme dhe baze për formimin e tyre si specialist në sektorin e Agro-ushqimit.

Kjo diplomë ju ofron mundësi të gjithë atyre që përfundojnë këto studime të njihen me teknologjitë e përpunimit, konservimit të kontrollit të cilësisë dhe të certifikimit të produkteve ushqimore.

b) Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin

Synimet kryesore të programit të studimit “Bachelor” që do të merren në këtë kurs studimi janë :

- ❖ Të përgatisë specialistë të kualifikuar të aftë të përballen me sfidat e kohës për të drejtuar linja dhe fabrika agro-përpunuese
- ❖ Të përgatisë specialistë të aftë për të punuar në pika doganore si inspektore të cilësisë të produkteve ushqimore
- ❖ Të përgatisë specialistë konkurrentë për pedagogë të rinj në institucione arsimore të mesme e të larta.
- ❖ Të përgatisë një brez punonjësish me vizione në të ardhmen për të drejtuar linja dhe fabrika të përpunimit agro-ushqimor si të frutave dhe perimeve dhe produkteve laktologje

c) Mundësitë për punësim

Një specialist i kësaj fushe mund të punësohet në të gjitha sektorët e bujqësisë, arsimit dhe shkencave bujqësore. Ai mund të punohet si :

- **Specialist ne laboratorin ushqimor ne DBUMK,**
- **Pranë inspektoratit te kontrollit te Metrologjisë dhe Peshëmatjes**
- **Në shkollat e mesme profesionale profil bujqësor si mësues. Etj.**
- **Si specialist dhe drejtues i linjave dhe fabrikave te rajonit te Korçës dhe me gjere ne industrinë Agro-ushqimore**

Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare

Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare

Në përputhje edhe misionin e afirmuar në ligjin PërArsimin e Lartë, Fakulteti i Bujqësisë ka synuar që nëpërmjet programeve që ofron të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë dhe qytetërimit të shoqërisë duke përgatitur të rinj profesionistë në degët përkatëse dhe qytetarë të denjë të një shoqërie që po integrohet në hapësirën evropiane.

Deri më sot është bërë një përpjekje për të vendosur një ekuilibër mes lëndëve të formimit të përgjithshëm dhe lëndëve me karakter profesional. Lëndët e formimit të përgjithshëm tentojnë të pajisin studentin me dije dhe njohuri të përgjithshme duke shfrytëzuar edhe traditën e Fakultetit të Bujqësisë në Universitetin e Tiranës.

4. STRUKTURAT AKADEMIKE PËRGJEGJËSE DHE STRUKTURAT E TJERA BASHKËPUNUESE

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	Fakulteti i Bujqësisë U.B Tiranës
Strukturat e tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	DBUMK Korçë. Qendra e Transformimi të Teknologjisë Bujqësore Korçë Universiteti Bujqësor i Tiranës.
Subjekte të tjera publike apo private.	Marrëveshje me dhomën e tregtisë, me bizneset e rajonit

5. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Cikli i studimit: (Cikli i studimit) është programuar në **3 vite/6 semestra me totale 180 ECTS.**

2. Për çdo vit studimi akademik, plani mësimor përmban **60 ECTS.**

Numri i përgjithshëm i njësive lëndore është 41, të modularizuara në 22 lëndë, duke përfshirë 2 lëndë e praktikës në institucion dhe të praktikës profesionale dhe 1 modul të tezës së diplomës.

3 Ngarkesa totale në auditor për çdo vit është programuar brenda intervalit: **nga 600-750 orë mësimore.** Për të tre vitet kjo ngarkesë (në auditor) është: **1926 orë**, prej të cilave **858 orë** leksion edhe **1068 orë** praktika, seminare, ushtrime, punë laboratorit etj.

4 Ngarkesa totale jashtë auditorit për çdo vit është programuar brenda intervalit **nga 750- 900 orë punë mësimore e studentit, (2544orë për të tre vitet)**. Format e mësimdhënies të programuara në planin mësimor janë leksione; seminare, ushtrime, pune laborator; praktikë profesionale etj.

6. PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT AGROUSHQIM CIKLI I PARË, VITI AKADEMIK 2014-2015

Viti I (parë)

[illegible]

Viti II (i dytë)

Nr	Disiplina apo titulli i Veprimtarisë	Tipi i veprim	Kredite	Leks.	Sem.	Lab.	Total	Semestri	Frekuentim
I	Bimët e arave dhe plehrimi i tyre	C	10	60	30	30	120		80%
1.	• Fitotekni	C	5	30	15	15	60	III	80%
2.	• Plehrat dhe plehrimi i bimëve	C	5	30	15	15	60	IV	80%
II	Biokimi dhe teknologjia qumështit dhe mishit	B	10	67,5	10	27,5	105		80%
1.	• Biokimi	B	5	30	5	10	45	III	80%
2.	• Teknologjia e përpunimit të qumështit dhe mishit	B	5	37.5	5	17.5	60	IV	80%
III	Shkenca e të ushqyerit të njeriut	B	5	37.5	15	-	52.5	III	80%
IV	Bazat e pemtarisë dhe perimtarisë	C	9	60	10	20	90		80%
1.	• Bazat e pemtarisë	C	4	30	5	10	45	III	80%
2.	• Bazat e perimtarisë	C	5	30	5	10	45	III	80%
V	Kimia dhe mikrobiologjia ushqimore	B	11	75	20	25	120		80%
1.	• Kimia ushqimore	B	5	30	15	15	60	III	80%
2.	• Mikrobiologjia ushqimore	B	6	45	5	10	60	IV	80%
VI	Drejtimi i Agrobiznesit	B	5	30	22,5		52,5	III	80%
VII	Prodhimi i Maltit dhe Mikrobiologjia bujqësore	B	10	60	45	15	120		80%
1.	• Teknologjia e prodhimit të maltit	B	5	30	30	-	60	III	80%
2.	• Mikrobiologji	B	5	30	15	15	60	III	80%
	GJITHSEJ		60	390	152,5	117,5	660		

Viti III (i tretë)

Nr	Disiplina apo titulli i Veprimtarisë	Tipi i veprim	Kredite	Leks.	Sem.	Lab.	Total	Semestri	Frekuentim
I	Proceset themelore&ruajtja e produkteve ushqimore	B	9	52	30	22	104		80%
1.	• Proc. them.tekn ushqim	B	5	26	26		52	VI	80%
2.	• Tekn.pas vjeljes	B	4	26	4	22	52	V	80%
II	Mbrojtja dhe ambalazhimi i prod.	B	10	78	17	35	130		80%
1.	• Ambalazhimi	B	5	39	13	13	65	VI	80%

2.	• Mbrojtja e bim bujqesore	B	5	39	4	22	65	V	80%
III	Tek. Perpun.produk.bujqesore	B	8	52	6	20	78		80%
1.	• Tekn.perpun.te drithrave	B	4	26	3	10	39	VI	80%
2.	• Tekn.perpun pijeve alkoolike	B	4	26	3	10	39	V	80%
IV	Bazat &metodat e analizave	B	5	26	9	30	65	V	80%
V	Cilesia dhe kontroll i prod.ushqim	B	10	65	26	13	104		80%
1.	• Cilesia mikrob.ushqimeve	B	5	39	13	-	52	VI	80%
2.	• Kontrolli &siguria e cilesise	B	5	26	13	13	52	V	80%
VI	Lista A	D	6	42	24	-	66	V,VI	80%
VII	Lista B	D	6	42	24	-	66	V,VI	80%
	Gjithesej		54	357	136	120	613		80%
	Diploma pergatitja e tezes	F	6				67		80%
	TOTALI		60				680		

LËNDËT ME ZGJEDHJE

NR	Emërtimi	SEMESTRI	Orë JAVORE
1	Kimi analitike	V	1.5/1
2	Mikrobiologjia e mishit dhe e produkteve të tij	V	1.5/1
3	Kontrolli i cilësisë së qumështit	VI	1.5/1
4	Enologjia	VI	1.5/1
5	Aditivët Ushqimore	VI	1.5/1

7. FREKUENTIMI NË VEPRIMTARITË E NDRYSHME FORMUESE

Frekuentimi i detyruar i auditorit (Leksione, seminare, laboratore)

Frekuentimi i leksioneve..... 70%

Frekuentimi i seminareve....100%

Frekuentimi i laboratoreve ...100%

Studenti është i detyruar të ndjekë *Praktikat profesionale te* parashikuara në planin mësimor. Ato organizohen në grupe me numër të pacaktuar dhe zhvillohet në institucionet publike, në kompani private dhe në profesionet e lira. Studenti duhet te mare pjesë në procesin e prodhimit të produkteve agroushqimore dhe të përgatisë një raport mbi procesin teknologjik dhe të jape argumente (nëse ka) për përmirësimin e tij. Praktika zhvillohet e integruar vetëm për lëndë të caktuara që parashikohen ne këtë program.

8. FORMAT E STUDIMIT DHE TË VLERËSIMIT

Koha e studimeve dhe kreditet

1.Koha e studimeve ndahet në:

-studime të ciklit të parë (diplomë universitare “Bachelor”), semestri 1-6

2. Koha e rregullt e studimeve në ciklin e parë (Bachelor) zgjat 3 vjet.

Për ciklin në fjalë nuk ka kufizim në zgjatjen e periudhës së përfundimit të studimeve.

3.Studentët që nuk përfundojnë studimet në kohën e rregullt janë të detyruar t’i nënshtrohen tarifës së shkollimit.

4.Në përfundim të studimeve të ciklit Bachelor, studenti duhet të arrijë të fitojë 180 kredite.

Vlerësimi i studentit

1.Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: **vlerësimi i vazhdueshëm** gjatë vitit për elementet e përcaktuar në programin e disiplinës a modulit dhe **vlerësimi përfundimtar**.

2.Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit përfaqëson 30% të vlerësimit total. Përbërësit e vlerësimit të vazhduar bëhen nga çdo pedagog në programin e disiplinës a modulit dhe pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit.

3.Studentëve, në përfundim të programit të studimit, u njehsohet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet përkatëse për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese. Njehësimi i mesatares së ponderuar bëhet sipas Aneksit të kësaj rregulloreje.

4.Për çdo program studimi të ciklit të parë nuk mund të parashikohen në total më shumë se 22 lëndë. Për çdo program studimit të ciklit të dytë nuk mund të parashikohen më shumë se 14 provime apo forma të tjera të vlerësimit përfundimtar.

5. Vlerësimi përfundimtar(provimi) mund të bëhet për një disiplinë apo për një veprimtari formuese me module të koordinuara. Për veprimtaritë formuese me dy a më shumë module bëhet vlerësim kolegjal i studentit. Secili modul ka kreditet e veta. Për nxjerrjen e notës përfundimtare në këtë veprimtari formuese studenti duhet t’i fitojë të gjitha modulet që e përbëjnë atë. Në qoftë se studenti kalon në modulën përkatëse, ai i merr të gjitha kreditet e tij. Kreditet e grumbulluara nga studenti llogariten si shumë e krediteve të moduleve të marra nga ai. Nxjerrja e notës mesatare përfundimtare bëhet duke patur për bazë mesataren e ponderuar të notave të marra në modulet që e përbëjnë atë. Në rast se nota mesatare përfundimtare nuk del numër i plotë, nota vihet 1 më shumë se pjesa e plotë.

Në përfundim të procesit mësimor (në orët e fundit të mësimin), çdo pedagog që është përgjegjës lënde duhet t’u komunikojë studentëve në auditor:

1.fitimin ose jo të së drejtës për t’u futur në provimin e disiplinës (modulit) përkatëse;

2.rezultatit të vlerësimit të vazhdueshëm në seminare, laboratore, tema e detyra kursi apo në forma të tjera të kontrollit të ushtruar gjatë semestrit, si pjesë e vlerësimit përfundimtar.

3.rezultati i vlerësimit të vazhdueshëm merret parasysh vetëm në vlerësimin përfundimtar të studentit, në sezonin e parë të provimeve.

Llojet e provimeve

1.Kontrolli i dijeve mund të bëhet: a) me shkrim, b) me gojë, c) i kombinuar (me shkrim e me gojë). Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.

2.Tezat e provimit hartohen nga titullari i disiplinës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.

3. Gjatë zhvillimit të provimit (me shkrim ose me gojë) nuk lejohet ndërrimi i tezës.

4. Zgjedhja e formës së provimit bëhet nga pedagogu/ët i lëndës dhe pasqyrohen në rregulloren mësimore të programit të studimit qysh në fillim të semestrit, duke ua bërë të ditur studentëve.

Kohëzgjatja e provimeve

1.Kohëzgjatja e një provimi me gojë është jo më shumë se 30 minuta për çdo student, ndërsa provimi me shkrim gjat jo më pak se 2 orë.

2.Pas dhënies së tezës në provimin me shkrim, nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit apo kursit përkatës.

3.Anëtarët e komisionit të provimit të disiplinës mbikqyrin zhvillimin korrekt të provimit gjatë gjithë kohës, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit.

Studenti, i vlerësuar mbetës në dy sezonet e rregullta të provimeve (të dimrit dhe të verës), ka të drejtë:

1.Të përdorë të gjitha datat e shpallura nga fakultetet në sezonin e vjeshtës.

2.Për të kaluar në vitin e dytë (semestri i tretë), studenti që ndjek studimet në sistemin me kohë të plotë duhet të ketë përfituar minimumi 20 kredite dhe studenti që ndjek studimet në sistemin me kohë të pjesshme 15 kredite.

4.Për të kaluar në semestrin e pestë, studenti që ndjek studimet në sistemin me kohë të plotë duhet të ketë përfituar minimumi 60 kredite dhe studenti që ndjek studimet në sistemin me kohë të pjesshme 45 kredite

8.Ridhënia e provimeve për disiplinat(modulet) e pashlyera, lejohet gjatë vitit në vazhdim në sezonet e shpallura të provimeve (tri herë në vit) ose deri në vitin e fundit të studimeve.

Diplomimi.

1.Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës profesional. Diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim formimi*.

**shtuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 12, datë 02.04.2010*

2.Departamentet përcaktojnë listën e tezave për diploma në fillim të semestrit të pestë. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti.

3.Drejtuesit e tezave të diplomës miratohen nga përgjegjësi i departamentit.

4.Studenti merr përsipër shpenzimet për realizimin e temës së diplomës.

1.Diplomimi bëhet në sezonin e dimrit (mars), në sezonin e verës (korrik) dhe në sezonin e vjeshtës (shtator).

2.Studentit i lejohet të mbrojë tezën e diplomës vetëm mbasi të ketë shlyer provimet e prapambetura.

Kërkesat për tezat e diplomës

1.Në rregulloret mësimore të programit të studimit Bachelor përcaktohen fushat dhe kërkesat për mbrojtjen e tezës të diplomës universitare “Bachelor”. Kërkesat përfshijnë aspekte të përmbajtjes dhe të formës së paraqitjes së diplomës.

2.Në përcaktimin e treguesve mbi përmbajtjen dhe formën mbahen parasysh kërkesat që përmbahen në udhëzimet e MASH-it. Për fitimin e diplomës universitare „Bachelor“ parashikohet përgatitja e një teze diplome, pa kërkesa për originalitet të veçantë.

Teza e diplomës të nivelit të parë është një punim, në formën e një projekti apo përmbledhjeje punimesh të kryera në fushat e programit përkatës të studimit. Teza e diplomës përmban kërkesa, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit, të tregojë aftësitë e tij për të zgjidhur elementë të veçantë të detyrave, në fushën përkatëse. Teza e diplomës është e lidhur me disiplina të përafërta dhe

duhet të jetë individuale. Studenti që plotëson kriteret e përcaktuara nga kjo rregullore ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, dhe udhëheqësin e tij. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale.

STRUKTURA E PUNIMIT

Punimi duhet të shkruhet me shkrim Times New Roman, Font 12, Hapësira midis rreshtave 1,15.

1. HYRJE: PËRSE KJO TEMË? (2 faqe)

2. ÇËSHTJET THEMELORE NË FUSHËN E BRENDISË (3 faqe)

4. ARGUMENTET DHE ANALIZA E TË DHËNAVE (20 faqe)

5. PËRFUNDIME, PROPOZIME, BIBLIOGRAFI (5 faqe)

9. INFRASTRUKTURA NË DISPOZICION TË PROGRAMIT

Mjediset e departamentit:

Mësimdhënia kryhet në të tre godinat e universitetit. Sipërfaqja totale e ambienteve ku zhvillohen leksione, seminare dhe laboratore për të tre fakultetet e universitetit është 1380 m².

Shpërndarjen e fasiliteve, mjediseve, si dhe kapacitetet e tyre për realizimin e suksesshëm të procesit akademik, paraqiten si më poshtë :

Salla e leksioneve : 3 auditorë, në të cilët zhvillojnë procesin akademik 80 studentë

Salla e Seminareve: Numri i tyre është 11 me një kapacitet prej 25 studentësh.

Biblioteka: E cila përmban strukturën e nevojshme për të vendosur një numër prej 10 000 librash.

Sekretaria Mësimore: Është njësia pranë së cilës zhvillohet procesi administrativ brenda Fakultetit, e cila është e pajisur me paisjet e duhura për zhvillimin normal të punës administrative, dhe konkretisht 4 sete Kompjuterash, 3 printer-skaner dhe printer – fotokopje. Pranë sekretarisë mbahet edhe një pjesë e Arkivit, si edhe regjistrat bazë të shkollës.

Salla e Pedagoqeve:Në Fakultet është në dispozicion një sallë pedagogësh që shërben edhe për kontaktet e shpeshta dhe komunikimin mes pedagogëve dhe studentëve.

Zyra e Dekanit:Ku Dekani kryen të gjithë veprimtarinë e tij administrative, është e pajisur me set Kompjuteri, printer, rafte arkivimi, Bibliotekë personale, kënd pritjeje etj.

Arkiva qendrore:Ndodhet në zyrën e sekretarisë.